

Ministri i Ekonomisë në bazë të nenit 51 paragrafi 6 të Ligjit për Duhan, Produkte të Duhanit dhe Produkte të Ngjajshme (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 98/19) miraton

## RREGULLORE

**PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE MËNYRËN E MBAJTJES SË REGJISTRIT TË ETIKETAVE TREGTARE TË DUHANIT DHE PRODUKTEVE TË NGJAJSHME DHE PËRMBAJTJEN E FORMULARIT TË KËRKESËS PËR REGJISTRIM NË REGJISTRIN E ETIKETAVE TË PRODUKTEVE TË DUHANIT DHE PRODUKTEVE TË NGJAJSHME**

### Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet forma, përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes së Regjistrit të etiketave të duhanit dhe produkteve të ngjashme dhe përmbajtjen e formularit të kërkesës për regjistrim në Regjistrin e etiketave të duhanit dhe produkteve të ngjashme.

### Neni 2

Regjistri i etiketave të produkteve të duhanit dhe produkteve të ngjashme mbahet në formë elektronike.

Forma dhe përmbajtja e regjistrit nga paragrafi 1 i këtij neni janë dhënë në Shtojcën 1, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

### Neni 3

Përmbajtja e formularit të kërkesës për regjistrim në Regjistrin e etiketave të produkteve të duhanit dhe produkteve të ngjashme është dhënë në Shtojcën 2, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

### Neni 4

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, përfundon vlefshmëria e Rregullores për formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrit të prodhuesve, eksportuesve dhe importuesve të produkteve të duhanit dhe Regjistri i etiketave të produkteve të duhanit dhe përmbajtja e formularit të kërkesës për regjistrim në Regjistrin e etiketave të produkteve të duhanit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 31/07).

## Neni 5

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 11-4270/7

14 tetor 2019

Shkup,

Ministër: Kreshnik Bekteshi, n.p



Formulari i Regjistrimit

Republika e Maqedonisë së Veriut

Ministria e Ekonomisë

**REGJISTRI I ETIKETAVE TË PRODUKTEVE TË DUHANIT DHE PRODUKTEVE TË NGJAJSHME**

Faqja e kopertinës



\_\_\_\_\_  
Numri arkivor dhe data

Drejtuar **MINISTRISË SË EKONOMISË**

**-Sektori për Bashkëpunim Tregtar Ndërkombëtar**

**KËRKESË PËR REGJISTRIM NË REGJISTGRIN E ETIKETAVE TË PRODUKTEVE TË  
DUHANIT DHE PRODUKTEVE TË NGJAJSHME**

Nga

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
(emri dhe selia e subjektit)

Kërkojmë të na regjistroni në Regjistrin e etiketave të produkteve të duhanit dhe produkteve të ngjajshme të etiketës tregtare: \_\_\_\_\_

Shenjëzo llojin e produktit me

- |  |  |
|--|--|
| <input type="checkbox"/> Cigare  | <input type="checkbox"/> Duhan për thithje                 |
| <input type="checkbox"/> Цигарилоси  | <input type="checkbox"/> Duhan për përtpje                 |
| <input type="checkbox"/> Puro  | <input type="checkbox"/> Duhan që nuk digjet               |
| <input type="checkbox"/> Duhan për llullë                                    | <input type="checkbox"/> Lëng për e-cigaretë               |
| <input type="checkbox"/> Duhan për mblështjellje të mëvetësishme të cigareve |  |
| <input type="checkbox"/> Duhan për llullë me ujë (nargile)                   | <input type="checkbox"/> Bimore (prej bimëve) pirje duhani |

Kërkesës për regjistrim në Regjistrin e Etiketave të Produkteve të Duhanit dhe Produkteve të Ngjajshme i bashkëngjiten këto dokumente:

- Gjendja aktuale origjinale e personit juridik, elëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Fletëpagesë origjinale për taksë të paguar administrative në vlerë prej 250 denarë;
- Fletëpagesë origjinale për taksë të paguar administrative në vlerë prej 50 denarë;

-Ekzemplar origjinal ose e vulosur në noter të Marrëveshjes së Shpërndarjes së Produktit, me përkthim, ose

- Autorizim origjinal nga bartësi i etiketës tregtare për shpërndarjen e etiketës tregtare në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut; ose

- Ekemplar origjinal ose ekzemplar i vulosur në noter të Marrëveshjes për Prodhimtari të Licencuar, të paraqitur në Entin e Pronësisë Industriale.

- Ekzemplar origjinal ose i vulosur në noter të Aktvendimit të Entit Shtetëror të Pronësisë Industriale për pranimin e etiketës tregtare ose ekzemplar nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO) ose Zyrës së BE-së për Pronësinë Intelektuale (EUIPO).

Telefoni dhe personi i kontaktit

---

Personi përgjegjës

---

(emri dhe mbiemri)